



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---------------------|---------------------------------|------------------------------|------------------|
| Enver Bytyçi | 04.01.2024 | 15.01.2024 | 2024/0003 |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.01.2024, OE “Pro & Co Group SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0003, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "HARST Group" SH.P.K., Harstgroup, 23000 Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i fushave te tenisit – Qendra Sportive ne Prizren” me nr. të prokurimit: "207-23-10441-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 625,000.00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0003 i dt:03.01.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat,:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

” Arsyeya e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:

Nuk ploteson kriteret:

Grupi i Operatoreve Ekonomik Pro&Co Group Shpk; Archi Time Shpk; FlorinG Shpk; Euro Commerc Nuk ka Prezantuar deshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate ka perfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne vlere minimum 550,000.00 Euro (projektet te realizuara ne lemin e ndertimit te objekteve sportive, stadiumeve apo salllave sportive qe perfshijne tribunat) dhe Nuk ka prezantuar ISO Standarde per te gjithë anetaret e grupit, Ne perputhje me nenin 26.6 te Rregullores per Prokurim Publik, “Certifikatat per sigurimin e cilesise, permenden ne nenin 70 te LPP-se dhe kane per qellim te vertetojnë pershtatshmerine e operatorit ekonomik me nje numer te caktuar standardesh per sigurimin e cilesise. Nese Autoritetit Kontraktues kerkon certifikata te hartuara nga organe te pavarura qe kryejne aktivite te certifikimit per te vertetuar se operatori ekonomik permbush standarde te caktuara per sigurimin e cilesise qe bazohen ne standarde kosovoare, evropiane ose nderkombetare, secili anetar i grupit do te deshmoj se i permbush standartet perkatese”.

Pergjigje 1-rë ne arsyen e pretenduar nga AK-es per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar sepse neve nuk na mungojnë referencat e natyrës së kontratës, pasi që në listën e kontratave janë të paraqitura 7 (shtatë) projektet të cilat e plotësojnë vlerën e kërkuar në DT dhe NJK:

1. Rregullimi i fushave sportive ne komunen e Vitisë – memorandumit me MAPL-n, me vlerë 124,538.11 € - Komuna e Vitisë;
2. Rregullimi i fushës ndihmëse në Pozheran-faza e dytë, me vlerë 82,698.45 € - Komuna e Vitisë;
3. Rregullimi i fushës ndihmëse në Pozheran, me vlerë 233,000.00 € - Komuna e Vitisë;
4. Rregullimi i fushave sportive ne Komunen e Vitisë, me vlerë 167,605.55 € - Komuna e Vitisë;
5. Terenet sportive ne shkollat e komunës së Gjilanit “SHMF Sadullah Brestovci Gjilan LOT 2”, me vlerë 42,945.60 € - Komuna e Gjilanit;
6. Terenet sportive ne shkollat e komunës së Gjilanit “SHMF Aferdita, Kishna Pole LOT 5”, me vlerë 56,250.15 € - Komuna e Gjilanit
7. Ndërtimi i Stadiumit në Viti, me vlerë 324,926.80 € - Komuna e Vitisë.

Këto projekte janë të dëshmuara me referenca dhe pranime teknike të cilat dëshmojnë vlerën e kontratës dhe natyrën e tyre. Por për ta dëshmuar edhe më tutje që këto shtatë (7) projekte janë të natyrës së kontratës po ju bashkangjesum Kontratat e këtyre projekteve bashkë me Paramasat e tyre.

Pergjigje 2-të ne arsyen e pretenduar nga AK-es per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es është i pabazuar sepse në DT nuk është kërkuar që secili nga anëtarët e grupit të prezantojë ISO Standardet dhe askund në nenin 70 të LPP-së nuk shkruan që “secili anetar i grupit duhet të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse” siç pretendon AK.

Në DT tek kapaciteti teknik dhe profesional pika 2 kerkohet (citat):

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me - ISO 9001-2015 - ISO 14001-2015 - ISO 31000- 2018 - ISO 39001-2012 - ISO 45001-2018; Dëshmia 1. Kopjet valide të certifikatave.

Që do të thotë që grupi i operatorëve duhet ta plotësojë këtë kriter, dhe jo siç e quani ju që secili nga anëtarët e grupit ta plotësojë këtë kriter.

Ne për këtë kriter kemi prezantuar tek ju Iso Standardet e Anetarve të Grupit Pro&Co Group Shpk (i cili është Lideri) dhe Archi Time Shpk.

Te bashkangjitur i gjeni përsëri ISO Standardet të cilat i kemi prezantuar.

Si përmbledhje e fakteve dhe argumenteve vlen të theksohet se AK-es ka bere shkelje te renda te LPP-se, perkatesisht po tenton me vendime arbitrate te demtoj buxhetin Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke rekomanduar për dhënie të kontratës një ofertë të një Operatori Ekonomik me çmim më të lartë edhe pse Kriteri për dhënie të Kontratë është Çmimi më i ulët. Oferta e OE-së te rekomanduar per dhenie te kontrates eshte 562,562.00 Euro, ndersa oferta jone eshte 488,888.00 Euro.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë anulimin e vendimit per vendimin e tenderuesit të suksesshem i cili vendim eshte bere ne shkelje te rende te LPP-se dhe Ligjeve ne fuqi dhe kete lende ta ktheje ne rivleresim duke respektuar dispozitat e LPP-s. I rezervojme te gjitha te drejtat tona ligjore qe te mbahemi te informuar ne te gjitha fazat e ketij procesi.

KRITERET PËR VLERËSIM

| | Kërkesat e përshtatshmërisë: | Dëshmia e kërkuar dokumentare: |
|--|---|--|
| | Kërkesa numër 1 Deklarata nën betim se operatori ekonomik i përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë sipas LPP nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 – forma Aneksi 2, dosja e tenderit. | Dëshmitë për kërkesën nr.1 Deklaratë nën betim - e plotësuar, e nënshkruar dhe e vulosur. |

| | | | |
|--|-----------|---|--|
| | | <p>Kërkesa numër 2 Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit -vetëm për fituesin.</p> <p>Kërkesa numër 3 Vërtetimin nga Gjykata- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë”- te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit, origjinal kopje e noterizuar - vetëm për fituesin.</p> | <p>Dëshmitë për kërkesën nr.2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin.</p> <p>Dëshmitë për kërkesën nr.3 Vërtetimin nga Gjykata - origjinal ose kopje e noterizuar- vetëm për fituesin.</p> |
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | 7.1 & 7.2 | <p>Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>Kërkesa numër 1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.</p> <p>Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhet ta paraqes edhe dokumentin për regjistrim të TVSH-së.</p> | <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmitë për kërkesën nr.1. Certifikatë valide të regjistrimit të biznesit – kopje dhe dokumentet përcjellëse.</p> <p>Dëshmitë për kërkesën nr.2. Kopja e vërtetimit të regjistruar si OE tatimpagues i TVSH-së.</p> |
| Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare | 8.1 & 8.2 | <p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më</p> | <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit</p> |

| | | | |
|--|----------------------|---|--|
| | | <p>pak se 1,000,000.00 Euro</p> <p>2. Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te kete min. 60% te mbeshtetjes bankare) - 100,000.00 Euro</p> | <p>2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë original i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar.</p> |
| <p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p> | <p>9.1 & 9.2</p> | <p>kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)</p> <p>2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me - ISO 9001-2015 - ISO 14001-2015 - ISO 31000-2018 - ISO 39001-2012 - ISO 45001-2018</p> <p>3. OE duhet te jete i licencuar leje per aktivitete te veqanta për prodhimin e bazës se betonit</p> | <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i></p> <p>Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve</p> <p>Dëshmia 1. Kopjet valide te certifikatave.</p> <p>Dëshmia 3- Kopja e licences lejes per aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>4. Lista e stafit profesional - Menaxheri i projektit – inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 5 vite përvijë profesionale - Udhëheqësi i punishtes – inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 3 vite përvijë profesionale - Inxhinier i hidroteknikës - së paku 3 vite përvijë profesionale - Inxhinier i Komunikacionit - së paku 3 vite përvijë profesionale - Inxhinier i Elektroteknikës - së paku 3 vite përvijë profesionale</p> <p>Sqarime plotësuese</p> | <p>duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.</p> <p>Dëshmia 4 - Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur. Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit dhe pozitave tjera. Kopjet e diplomave të noterizuara (Noterizimi jo më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). CV dhe referenca që dëshmojnë përvijën e kërkuar. Nëse OE nuk ka staf permanent atëherë si dëshmi duhet ofruar kontratat e noterizuara me emër dhe numër të projektit.</p> <p>Autoriteti kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.</p> |
|--|--|--|--|

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

| |
|--|
| |
|--|

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

OE NPN EUROING SH.P.K. Nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)

B36 Formulari standard "Raport i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur

16

Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. ATC COM SH.P.K.; DAJTING SH.P.K. , Nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtarët e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse".

Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; ARCHI TIME SH.P.K.; FlorinG SH.P.K.; Euro Commerec Nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna) shi dhe Nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtarët e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse".

Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA Pro- Ing SH.P.K.; ENGINEERING RK SH.P.K. Nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna) shi dhe Nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtarët e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse".

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues konsiderohet palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Pro & Co Group SH.P.K.

Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit: "Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren" me nr. të prokurimit: "207-23-10441-5-1-1".

Me datë 28.09.2023 është publikuar njoftimi për kontratë;

Me datë 10.11.2023 Afati për dorëzimin e ofertave;

Me datë 22.12.2023 Formulari B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK;

Me datë 27.12.2023 OE ka bërë kërkesën për rishqyrtim pranë AK;

Me datë 27.12.2023 AK ka nxjerrë vendimin mbi shqyrtimin e kërkesës dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar;

Me datë 03.01.2024 OE ka paraqitur ankesë pranë OSHP me pretendimet ankimore;

Me datë 04.01.2024 OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për vlerësimin dhe shqyrtimin e ankesës së OE ankues.

Eksperti shqyrtues sipas autorizimit të datës 04.01.2024 në pajtim me LPP, ka shqyrtuar lëndën dhe pretendimet ankimore të OE ankues.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues në pretendimin ankimor 1 nuk është pajtuar me vlerësimin e AK në lidhje me kërkesën kapacitetet teknike dhe profesionale ku AK ka vlerësuar se OE nuk i ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme se në 3 vitet e fundit ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerën e kërkuar në DT. OE ka ofruar dëshmitë në lidhje me prezantimin e dokumenteve që dëshmojnë përfundimin me sukses të projekteve të natyrës së ngjashme për 3 vitet e fundit.

Përgjigje në pretendimin 1

Eksperti sqaron se AK në DT ka vendosur kërkesën në 9.1 & 9.2. Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)

Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Eksperti pas shqyrtimit të dokumenteve dhe në bazë të kërkesës së DT konsideron se AK në dosjen e tenderit ka vendosur kërkesën për realizimin me sukses të kontratave të “ngjashme” (jo të njëjta apo identike). Sipas opinionit të dhënë nga KRPP termi “e ngjashme” nuk do të thotë se natyra e kontratës të jetë identike apo e njëjtë me përshkrimin e objekteve të dhëna në DT. Kontrata të ngjashme sipas përshkrimit të termit “ngjashme” të dhënë sipas opinionit të KRPP mjafton të jetë projekt objekt ndërtimor sportiv, ku mund të përfshihen edhe kategorizimi i kontratave të objekteve të ndërtimit të lartë.

Sa i përket plotësimit të kërkesës eksperti sqaron se kërkesa e AK ka të bëjë me “objektet sportive, stadione apo salla sportive që përfshijnë tribuna” që do të thotë se mjafton njëra nga këto llojet e objekteve të prezantohet në vlerën e kërkuar dhe kërkesa është e arritur sipas natyrës së kontratës.

AK gjatë vlerësimit është kufizuar në njërin prej përshkrimit të dhënë konkretisht “tribunat”. Përshkrimi i dhënë “tribunat” për të cilin është bazuar AK është pjesë e objektit ndërtimor dhe nuk paraqet objekt të veçantë ose natyrë specifike të projektit ku dihet se shumica e objekteve sportive kanë si pjesë të ndërtimit edhe tribunat.

Eksperti në bazë të shqyrtimit të dokumenteve të ofertuesit konsideron se OE ankues ka ofruar listën e kontratave të ngjashme të dëshmuara sipas kërkesës së DT dhe ka arritur vlerën e kërkuar nga AK në DT (shënim: pas verifikimit të kontratave në sistemin e prokurimit elektronik të prezantuar nga OE ankues, pothuaj të gjitha kontratat e objekteve sportive të prezantuar kanë pozicione të ndërtimit të tribunave, po ashtu vlene të theksohet se edhe OE i propozuar për kontratë nga AK në mënyrë të njëjtë i ka të specifikuar pozicionet e tribunave në kontratën e prezantuar).

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 1 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

Pretendimi ankimor 2 ka të bëjë me çështjet e standardeve ISO ku AK këto standarde i ka kërkuar si pjesë e kërkesës 9.1 & 9.2 Kërkesat teknike dhe profesionale :

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me - ISO 9001-2015 - ISO 14001-2015 - ISO 31000-2018 - ISO 39001-2012 - ISO 45001-2018

Dëshmia 1. Kopjet valide të certifikatave.

OE ankues nuk është pajtuar me vlerësimin e AK se të gjithë pjesëmarrësit në grup duhet të kenë certifikatat e kërkuara. OE ka dhënë sqarime se sipas LPP kërkesat teknike dhe profesionale janë kërkesa ku kërkohet që grupi i operatorëve duhet të plotësojë këtë kriter e jo siç pretendon AK që secili anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter.

Përgjigje në pretendimin 2

Eksperti i ka shqyrtuar kërkesat e DT dhe dokumentet e ofruara nga OE ankues, eksperti konsideron se AK kërkesën për certifikatat e ka vendosur tek kriteret e FDT neni 9.1 & 9.2 - **Kërkesat teknike dhe profesionale**. Sipas LPP neni 69, paragrafi 8 e përcakton se një grup i OE për kërkesat sipas këtij neni, mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjektet tjera.

Gjithashtu sipas RrPP 001/2022, neni 26.5 e përcakton se çdo kërkesë e vendosur nga AK sipas nenit 66.2, neni 68 dhe neni 69 të LPP-së **aftësia teknike dhe profesionale** do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Pra çdo kërkesë e AK e vendosur tek Kërkesat Teknike dhe Profesionale në FDT, neni 9.1 & 9.2, do të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Pro & Co Group SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren” me numër të prokurimit: “207-23-10441-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi e jo ndaj anëtarëve individual të grupit, kështu që mjafton njëri nga anëtarët e grupit të plotësoj kërkesën e DT.

Eksperti konsideron se kërkesa e DT është plotësuar nga OE ankues, pasi që njëri nga anëtarët pjesëmarrës të grupit ka dorëzuar dokumentet e kërkuara.

AK në këtë rast ka bërë shkelje, duke vlerësuar se të gjithë anëtarët e grupit individualisht duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura ne 9.1&9.2 te DT, sipas nenit 69 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 2 është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjithashtu ju informoj se per kete aktivitet te prokurimit eshte parashtruar edhe nje ankese nga nje OE tjeter.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Pro & Co Group SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren” me numër të prokurimit: “207-23-10441-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Pro & Co Group SH.P.K.**


Enver Bytyçi

